



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:068347
Datë: 27.06.2024
Numri i dokumentit: 05869233

2024:068348

Gjykata Themelore në Ferizaj, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.H. me vendbanim në fsh...-K.Ferizaj, me nr. personal 1170881393, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. Arbnor Hasani nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj-DKA, me objekt kontesti pagesë e pagave mujore, me vlerë të kontestit të pacaktuar, më dt. 27.06.2024 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Konstatohet tërheqja e padisë** së paditëses M.H. me vendbanim në fsh...-K.Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj-DKA, me objekt kontesti pagesë e pagave mujore, me vlerë të kontestit të pacaktuar.
- II. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta të procedurës.**

Arsyetim

Me datë 29.02.2024 paditësja ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt kontesti pagesë e pagave mujore. Paditësja përmes të autorizuarit të saj Av. Arbnor Hasani nga Ferizaj para mbajtjes të seancës përgatitore të dt. 05.07.2024, ora 10:15, i ka dorëzuar gjykatës me dt. 26.06.2024 parashtrësë në të cilën theksojnë se e tërheqin padinë kundër të paditurës meqë për paditësen në një çështje tjetër ishte i angazhuar një avokat tjetër, i njëjti tashmë kishte inicuar procedurë edhe sa i përket mospagesës së pagave mujore, andaj meqenëse kjo procedurë kontestimore tashmë është zgjidhur e njoftojmë gjykatën se e bëjmë tërheqjen e padisë.

Prandaj gjykata me aplikimin e nenit 261.1 të LPK lidhur me nenin 381.1, pika c) të LPK nxjerrë aktvendim si në dispozitiv dhe konstatohet tërheqja e padisë.

Gjykata vendosi si në pikën II. të aktvendimit, që secila palë i mbulon shpenzimet e veta të procedurës duke u bazuar në nenin 450 të LPK.

Nga të gjitha të lartcekurat, e konform nenit 142 të LPK u vendosë si në dispozitiv.

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK.